

Datë: 20/10/2020

KONKLUZIONE NGA KËSHILLIMI PUBLIK I DOKUMENTIT

“Draft doumenteve të analizës së tregut të terminimit të thirrjeve me zë në rrjetet publike mobile”

Draft dokumentet e analizes së tregut të terminimit të thirrjeve me zë në rrjetet publike mobile janë përgatitur në përputhje me nenin; 10, paragrafi 5, neni 31, paragrafi 8), neni 79, paragrafi 1) dhe 2) dhe neni 82 paragrafi 1) dhe 3) (tutje referuar si - Ligji); Rregullores Nr. 42 për Analizat e Tregut (Ref. ARKEP Nr. Prot. 110/B/19), neni 3, paragrafët 3.1) dhe 3.10) (tutje referuar si - Rregullorja për Analizat e Tregut), të cilët e obligojnë ARKEP-in që të kryej analizat e tregut për të përcaktuar ndërmarrjet me Fuqi të Ndjeshme në Tregjet përkatëse (tutje referuar si - FNT) dhe konform gjetjeve nga analiza të vendosë detyrimet/ obligimet ndaj ndërmarrjeve në fjalë.

Me vendimin Nr.1615 (Ref. Nr.Prot.038/B/20; dt.29/07/2020) Bordi i ARKEP ka miratuar fillimin e këshillimit publik, i cili ka zgjatur nga data 06 Gusht 2020 deri më datë 06 shtator 2020.

Gjatë periudhës së këshillimit publik komentet i kanë dërguar operatorët Telekom i Kosovës SH.A (tutje referuar si - TK) dhe IPKO Telecommunications LLC (tutje referuar si - IPKO) nddersa MTS d.o.o ka dërguar email duke njoftuar se nuk ka komente .;

- 1) **Komentet e TK;** janë dërguar më datë; 06/09/2020 (Ref. Shkresa/e-maili i datës 06 shtator 2020, 11:56 AM, Nr.Prot.363/2/20), me te cilin TK njofton se nuk kanë komente në dokumentet e analizes perveç datës së fillimit te implementimit të tarifave të reja të specifikuara në vendimet e ARKEP.
- 2) **Komentet e IPKO-së;** janë dërguar më datë; 28/08/2020 (Ref. Shkresa/e-maili i datës 28 gusht 2020, 1:30 PM) (Ref.Nr.Prot.355/2/20), të cilat kanë të bëjnë kryesisht me propozimin për ulje më të ndjeshme të tarifave të propozura në “glide path”.
- 3) **Komentet e mts d.o.o.** janë dërguar më datë; 09/09/2020 (Ref. Shkresa/e-maili i datës 09 shtator 2020, 2:27 PM, Nr.Prot.364/2/20), me të cilin mts d.o.o. njofton se nuk kanë komente në dokumentet e analizes.

Përmbledhje lidhur me komentet e operatorëve dhe propozimi i ARKEP

ARKEP ka shqyrtuar komentet e paraqitura nga dy operatorët dhe u ka dhënë përgjigje këtyre komenteve, të cilat janë paraqitur në shtojcën I dhe II të këtij dokumenti.

Përfaqësuesit e ARKEP gjithashtu kanë mbajtur nga dy takime të ndara (një online dhe tjetrin fizik) me përfaqësuesit e operatorëve Telekom i Kosovës sh.a. dhe IPKO Telecommunications LLC, ku është diskutuar në mënyrë të detajuar propozimi i ARKEP dhe qëndrimet e palëve.

Si përmbledhje e përgjigjeve mund të konkludojmë se propozimi i dalë nga *“Analiza e tregut të terminimit të thirrjeve me zë në rrjetet publike mobile”* pas reflektimit në komentet e operatorëve dhe konsultimet e përbashkëta që janë zhvilluar në vijim me ta, mbetet i qëndrueshëm, pasi që operatorët nuk kanë dhënë argumente bindëse për ta ndryshuar këtë. Kësaj ia shtojmë faktin se modeli i propozuar nga ARKEP i përshkallëzimit gradual *“glide path”* është në nivelin e mesëm krahasuar me propozimet e dhëna nga dy operatorët. Gjithashtu ky propozim konsiderohet të jetë në funksion të ruajtjes së stabilitetit të tregut duke u dhënë mundësi operatorëve t'u përshtaten kushteve të reja, dhe t'u shmangen rrezikut të ç'rregullimit të tregut që do të mund të vinte qoftë nga një rënie e ngadaltë apo nga një rënie drastike e tarifës.

Në anën tjetër, është praktikë standarde e rregullatorëve që të përdorin modelin *“glide path”* me rastin e rregullimit të reduktimit të tarifave të terminimit për një periudhë të caktuar kohore. Gjithashtu, mbetet në diskrecion të rregullatorit që të përcaktoj elementet për *“glide path”* si: kohëzgjatja, norma/shkalla e zbritjes, numri i periudhave, etj.

Për më tepër, Komisioni Evropian në Rekomandimin e fundit për orientimin në kosto të tarifave të terminimit (*Rekomandimi i Komisionit Eurpian i datës 7 Maj 2009 mbi trajtimin rregullator të tarifave të terminimit në rrjetet fikse dhe Mobile në BE (2009/396/EC)*) i referohet koston së vetme referente për të arritur simetri të tarifave të terminimit të thirrjeve mobile ndërmjet MNO-ve. Sipas rekomandimit në fjalë, MTR-të përcaktohen sipas koston së operatorit efikas (d.m.t.h Autoriteti duhet të përcaktojë dhe llogarisë koston e operatorit efikas). Vlerësimi i kostove efikase të bazohet në koston tanishme dhe përdorimin e kostove afatgjate inkrementale sipas metodologjisë së ashtu-quajtur nga poshtë-lartë (*“bottom-up”*), LRIC i pastër (pure LRIC).

Rekomandimi i Komisionit Evropian, në pikën 12 të tij trajton rastin e vendeve me kapacitete të kufizuara për ndërtimin e modelit BU LRIC të pastër, duke rekomanduar që këto vende mund të aplikojnë metoda alternative (si p.sh. modeli krahasimor -benchmark), por rezultatet e tyre nuk duhet të jenë më të mëdha se tarifa mesatare e terminimit e vendosur nga Autoritetet Rregullatore që kanë aplikuar metodologjinë e LRIC të pastër.

Në përcaktimin e tarifave, ARKEP mendon se është e nevojshme që krahas nivelit mesatar të MTR në vendet e BE dhe rajonit që kanë aplikuar metodologjinë LRIC, të marrë në konsideratë edhe kushtet aktuale dhe pritshmëritë për zhvillimin e tregut në Republikën e Kosovës, me qëllim të realizimit të objektivave rregullatore, rritjen e konkurrencës efektive në këtë treg me qëllim të maksimizimit të

përfitimeve të përdoruesve fundorë.

Andaj , duke marrë parasysh:

- specifikat e tregut në vendin tonë;
- komentet e operatorëve gjatë konsultimit publik;
- Mesataren e MTR të vendeve të BE-së dhe vendeve tjera rajonale që sipas datës 01 Janar 2020 është afërsisht 0.8531 eurocent/min;
- fakti që MTR aktuale është në zbatim nga muaji korrik 2018, e cila ishte përcaktuar si faza e fundit nga analiza e fundit e tregut, konsiderojme se për të nderlidhur dinamikën e ardhshme glide-path me atë të kaluarën, propozohet një normë rënës prej 10% në MTR aktual.


Nga këndvështrimi i ARKEP, të gjithë aktorët aktivë në tregun e komunikimeve elektronike funksionojnë në një ambient të barabartë, bazën e të cilit e krijon Ligji dhe në këtë kontekst Autoriteti i trajton njëjtë pavarësisht formave të pronësisë.

Pas shqyrtimit të komenteve të prezantuara nga Departamenti i Komunikimeve Elektronike (DKE), Bordi i Autoritetit në mbledhjen 57-të me radhë të mbajtur me datën; 02 Tetor 2020, miratoi dokumentin; **dokumentet e analizës së tregut të terminimit të thirrjeve me zë në rrjetet publike mobile** , të cilat janë të publikuara dhe mund të shkarkohen nga ueb faqja e ARKEP: www.arkep-rks.org.

Në vijim janë paraqitur përgjigjet e ARKEP në komentet e dërguara nga operatorët TK dhe IPKO.

SHTOJCA I

Metodologjia e ARKEP, bazuar edhe në komentet e operatorëve gjatë konsultimit publik (euro cent)



SHTOJCA II

Përgjigjet e Autoritetit ndaj komenteve/rekomadimeve të TK dhe të IPKO-së

Nr.	Komentet e TK	Përgjigja e Autoritetit
1.	<p>Draft-Raporti i analizës se tregut si dhe draftet e vendimeve për përcaktimin në mes operatorëve të tjerë dhe Telekomit të Kosovës si OFT, si duket është në kuadër të pritshmërive si dhe në linjë me raportet dhe vendimet e viteve të kaluara, pa marrë parasysh që nuk jemi treg i barabartë dhe me të drejta të barabarta me shtetet e EU.</p> <p>Dinamika e ndryshimit të MTR për periudhën Korrik-2020 deri Dhjetor-2021 është ashtu siç është pritur dhe konform trendit të zbritjes së MTR në Evropë në vitet e kaluara!</p> <p>Sidoqoftë, kërkesë e Telekomit të Kosovës, për aprovim është që data e parë e ndryshimit të MTR të jetë 1 Tetor 2020, pasi që tashmë faturat e muajve të kaluar-2020 janë dërguar/pranuar drejt/nga IPKO dhe Mts DOO.</p>	<p>Propozimi i ARKEP lidhur me fillimin e aplikimit të tarifave të reja për MTR “glide path” në draft dokumentet e Analizes se Tregut ka qenë e paraparë të filloj të aplikohent në korrik.</p> <p>Megjithatë për shak të vonese në fillimin e keshillimit publik, ARKEP e kosideron të pranueshme ndryshimin e dates se fillimit të aplikimit të “glide path”.</p> <p><u>Komenti pranohet</u></p>

Nr.	Komentet e IPKO	Përgjigja e Autoritetit
1.	<p>Bazuar në njoftimin për fillimin e procesit te konsultimit publik te dokumenteve për analizën e tregut 'terminimit të thirrjeve me zë ne rrjetet mobile individuale', në vijim ju lutem gjeni propozimin e IPKO's lidhur me çmimet e terminimit të thirrjeve mobile të origjinuara brenda territorit të Republikës së Kosovës:</p>	<p>Modeli i propozuar nga ARKEP për uljen e pershkallzuar ose “glide path” është mbështetur në nivelin e mesatar të uljes së MTR në vendet e BE si dhe MTR-të aktuale të vendeve të regjionit. Megjithatë, marrë parasysh trendet e zvellimit të tregut duke u bazuar në nenin 1, neni 40 paragrafet 3</p>

IPKO Proposal

Month	Jan-17	Jul-17	Jan-18	Jul-18	Jul-20	Jan-20	Jan-21
Kosova MTR	0.0174	0.01515	0.01318	0.01146	0.009168	0.007884	0.007490
Zvoglimi i MTR %		-12.93%	-13.00%	-13.05%	-20.00%	-14.00%	-5.00%

Propozimi i mësipërm, vlen të theksohet se është bazuar duke konsideruar shkallën rënëse të çmimit në BE prej 4.45% dhe tarifën mesatare aktuale 0.007312 Euro/Min. Në këtë drejtim, nëse konsiderojmë tarifën aktuale të propozuar nga ARKEP, atëherë mund të konkludojmë që në vitin 2022 me çmimin e vendosur prej 0.00946, Kosova do të jetë në pozitën ku Evropa ka qenë në vitin 2017, rrjedhimisht 5 vite mbrapa.

IPKO konsideron që zvogëlimi i tarifës së terminimit duhet të jetë me ritëm më të përshpejtuar në mënyrë që dalëngadalë të jemi në nivelin e BE. Marr parasysh faktin se, që nga korriku i vitit 2018 nuk ka pas ulje të çmimit të terminimit, atëherë propozimi ynë është që të shkohet me një përqindje më të lartë, në mënyrë që, çmimi i terminimit në vitin 2022 të jetë së paku sa çmimi i terminimit të vendeve të BE në janar të vitit 2020. Lidhur me këtë, më poshtë mund të gjeni edhe tabelën e analizës lidhur me çmimet e 'terminimit të thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale', të propozuara nga ARKEP, të propozuara nga IPKO dhe ato aktuale që mbizotërojnë në BE.

dhe 4 të LKE ARKEP duhet marr parasysh edhe rekomandimet e komisionit Evropian. Prandaj, marrë parasysh edhe komentet e pranuar, ARKEP konsideron që modeli glide path duhet të ketë një zbritje lineare prej 10% në tre faza duke filluar nga 1 Tetori 2020 (Shtojca I).

Faza e I: 01 Tetor 2020

Faza e II: 01 Janar 2021

Faza e III: 01 Janar 2022

Ky propozim konsiderohet të jetë në funksion të ruajtjes së stabilitetit të tregut duke u dhënë mundësi operatorëve t'u përshtaten kushteve të reja, dhe t'u shmangen rrezikut të çrregullimit të tregut që do të mund të vinte qoftë nga një rënie e ngadaltë apo nga një rënie drastike e tarifës.

Komenti Pjesërisht Pranohet

ARKEP Proposal							
Month	Jan-17	Jul-17	Jan-18	Jul-18	Jul-20	Jan-20	Jan-21
Kosova MTR	0.0174	0.01515	0.01318	0.01146	0.01046	0.009660	0.009460
Zvoglimi i MTR %		-12.93%	-13.00%	-13.05%	-8.73%	-7.65%	-2.07%
IPKO Proposal							
Month	Jan-17	Jul-17	Jan-18	Jul-18	Jul-20	Jan-20	Jan-21
Kosova MTR	0.0174	0.01515	0.01318	0.01146	0.009168	0.007884	0.007490
Zvoglimi i MTR %		-12.93%	-13.00%	-13.05%	-20.00%	-14.00%	-5.00%
EU Price							
Month	Jan-17	Jul-17	Jan-18	Jul-18	Jan-19	Jul-19	Jan-20
EU MTR	0.0097	0.0093	0.0089	0.0085	0.0078	0.0078	0.0074
Zvoglimi i MTR %		-4.12%	-4.30%	-4.49%	-8.24%	0.00%	-5.13%